



## UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

### FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS							
<b>Niveli i studimeve</b>	Bachelor	<b>Programi</b>	<b>Gjuhë dhe letërsi shqipe</b>	<b>Viti akademik</b>	2017-2018		
<b>LËNDA</b>	<b>Kulturë dhe qytetërim shqiptar</b>						
<b>Viti</b>	I	<b>Statusi i lëndës</b>	Zgjerdhore	<b>Kodi</b>		<b>ECTS kredi</b>	4
<b>Semestri</b>	dimëror						
<b>Javët mësimore</b>	15 (pesëmbëdhjetë)			Orët mësimore 30	Ligjërata 2	Ushtrime 1	
<b>Metodologjia e mëimit dhe përshkrimi i lëndës</b>	<p>Ky kurs u mundëson studentëve marrjen e njohurive të reja për kulturën dhe qytetërimin shqiptar, duke filluar nga kultura e hershme e deri ne ditët tona. Fillimisht studentët do të njihen me gjurmët më të hershme të shoqërisë njerëzore duke vazhduar me kulturën, besimin, mitologjinë, kulturën materiale ilire. Gjithashtu studentët do të marrin njohuri për gjuhën si fenomen shoqëror e kulturor, ndryshimin dhe evoluimin e saj në hapësirë dhe kohë, përkatësinë e gjuhës shqipe dhe vendin e saj në rrethin e gjuhëve indoeuropiane, me teoritë për prejardhjen e shqipes e të shqiptarëve, për kontaktet me etnitë dhe gjuhët e tjera. Studentët do të marrin njohuri edhe për kohën e mesjetës dhe rolin e shqiptarëve në këtë periudhë. Në pjesën e fundit të këtij kursi studentët do të njihen me periodikun shqiptar, me figurat e shquara të kulturë shqiptare të shekullit XIX dhe XX.</p>						
<b>Mësimdhënës</b>	Prof.ass.dr. Teuta Vinca Kafexholli						
<b>Asistent</b>	Xxx		e-mail	<a href="mailto:teuta.kafexholli@uni-prizren.com">teuta.kafexholli@uni-prizren.com</a>			

#### Qëllimi studimor i lëndës

##### Qëllimi i kursit Kulturë dhe qytetërimit shqiptar është që studentët:

- t'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën historike të identitetit kulturor të shqiptarëve.
- të njihen me mitologjinë shqiptare dhe kodin zakonor të tyre, si bazë e ndikimit për qytetërimin e mëvonshëm.
- të marrin njohuri mbi ndryshimet kulturore gjatë historisë, për trashëgëminë kulturore dhe elementet

antike krahas transformimeve të konteksteve kohore dhe hapësinore.

**Metodologjia për realizimin e temave mësimore:**

Ligjëratat do të organizohen në modelin ndërvepruese apo të kombinuar si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjëruarit.

**Kushtet për realizimin e temës mësimore:**

Laptop, projektor, prezantim etj.

**Mënyra e vlerësimit të studentit ( në%)**

Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.

**Pikët e vlerësimit:**

1. Testi i parë: 20 pikë
2. Testi i dytë: 20 pikë
3. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti 20 pikë
4. Punim seminari 10 pikë
5. Vlerësimi i fundit-testi përfundimtar 30 pikë.
6. Totali: 100 pikë

**Vlerësimi në %**

**Nota përfundimtare**

Vlerat e pikëve:

1. 50-60 = 6
2. 61-70 = 7
3. 71-80 = 8
4. 81-90 = 9
5. 91-100 = 10

Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën kaluese.

**Obligimet e studentit:** Të jetë pjesëmarrës aktiv, të punojë seminare; prezantimet dhe hulumtimet e pavarura. Gjatë ligjëratave nuk u lejonet komunikimi me telefon apo modele të tjera të cilat pengojnë procesin e mësimin. Gjatë organizimit të testeve nuk lejohet kopjimi, komunikimi apo ardhja me vonesë, sepse do të pengojë procesin e organizimit të testit.

Testet apo provimet organizohen sipas plan-programit të paraparë.

**Ligjëratat**

Në ligjëratat studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës.

**Ushtrime**

/

**Ngarkesa e studentit për lëndën**

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1-15	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	1-14	14
Seminare, prezantime, teste, kolokfiume etj.	4	2-2	8

Detyra të shtëpisë	2	1-4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1-2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	3	2	6
<b>Totali</b>			<b>100</b>

Java	Ligjërata	
	<b>Tema</b>	<b>Orët</b>
1.	<b>Hyrje në lëndën Kulturë dhe qytetërim shqiptar</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjeneza e shqiptarëve - përkatësia indoevropiane</li> </ul>	2
2.	<b>Strategjitë e komunikimit dhe teknikat e shkrimit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Strategjitë e komunikimit dhe shkrimit</li> <li>Akordimi i materialit me kohën në dispozicion</li> <li>Prezenca fizike përpara audiencës</li> </ul>	2
3.	<b>Qytetërimi ilir</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Jeta e përditshe dhe doket</li> <li>Vendbanimet dhe banesat</li> <li>Kultura material</li> </ul>	2
4.	<b>Nga iliria deri te bizanti</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Studimet për etnogjenezën shqiptare</li> <li>Ndikimi i latinishtes në gjithë Ballkanin në kohën e Perandorisë Romake</li> <li>Përmendjet më të hershme të shqiptarëve</li> </ul>	2
5	<b>Mendimet e dijetarëve të ndryshëm për çështjen shqiptare</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>A janë shqiptarët autokton apo ardhës?</li> <li>Pikëpamjet e disa studiuesve si N. Jokli, J. Thunmann, G. Hahni etj. për çështjen e autoktonisë</li> <li>Dëshmitë gjuhësore të lidhura me autoktoninë</li> <li>Toponomastika e lidhur me emrat e viseve të sotme në trojet shqiptare</li> </ul>	2
6.	<b>Mitologjia ilio-shqiptare</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Miti si lloj i veçantë i krijimtarisë popullore</li> <li>Elementet e mitologjisë në doket, zakonet, ritet e besimet popullore</li> <li>Mitologjia popullore shqiptare dhe rrënjët e saj që në lashtësi</li> <li>Ikonografia e hyjnive të ndryshme</li> </ul>	2
7.	<b>Vlerat juridike dhe kanunore të “Kanunit të Lekë Dukagjinit”</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vepër e madhe e kulturës tradicionale shqiptare në fushën e jetës sociale</li> <li>Ligjet e Kanunit si themel i sjelljes shoqërore dhe vetëqeverisëse në Shqipëri dhe Veriut</li> <li>At Shtjefën Gjeçovi dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit</li> </ul>	2

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mendimet e dijetarëve të ndryshëm për Kanunin</li> </ul>	
8.	Provimi i parë intermediar	2
9.	<b>Fillimet e kulturës dhe letërsisë në shekujt XVI e XVII</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tri sferat kulturore e gjuhësore në Shqipëri</li> <li>Karakteret fetar i kësaj kulture dhe dy faktorët ndikues</li> <li>Veprat dytësore të shekullit XVII që ndihmuan kulturën dhe qytetërimin shqiptar</li> </ul>	2
10.	<b>Shkrimet shqipe në traditën ortodokse</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tradita e këtyre shkrimeve në shekullin XVIII dhe në fillim të shekullit XIX</li> <li>Shqipja me alfabet grek e me alfabet të tjera</li> <li>Lulëzimi i qytetit të Voskopojës, qendër e tregtisë dhe kulturës qytetare shqiptare</li> <li>Vlerat e dorëshkrimit Elabasanas i Ungjijve (Anonimi i Elbasanit)</li> <li>Kontributi i kësaj periudhe në fushën e leksikologjisë</li> </ul>	2
11.	<b>Kultura arbëreshe në shekujt XVIII e XIX</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Veprat e para të letërsisë arbëreshe</li> <li>Kontributi i shkrintarëve dhe studiuesve arbëresh për kulturën shqiptare</li> <li>Vlerat e fjalorit italisht-shqip të N. Ketës</li> <li>Shkrimtarë arbëresh më pak të njohur të fillimit të shekullit XIX</li> <li>Ndihmesa e shkrintarëve dhe studiuesve arbëresh që shkruan italisht</li> </ul>	2
13.	<b>Gjuha shqipe dhe familja gjuhësore indoevropiane</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vendi i shqipes në familjen indoevropiane</li> <li>Karakteret indoevropian i shqipess në sistemin leksik, fonetik dhe në strukturën gramatikore</li> <li>Prejardhja e gjuhës shqipe</li> <li>Dialektet dhe gjuha standarde shqipe</li> </ul>	2
14.	<b>Shqiptarët më të famshëm në botë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nënë Tereze, personalitet që shërben si ambasadore e kulturës dhe vlerave shqiptare në botë</li> <li>Ferid Murati, nobelist në fushën e mjekësisë</li> <li>Aleksandër Moisiu, aktor i madh shqiptar</li> <li>Inva Mula, soprano me famë botërore</li> <li>Personalitete të tjera të kulturës shqiptare</li> </ul>	2
15.	Provimi i dytë intermediar	2

## LITERATURA BAZË

Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Pejë, 2001.  
 Aleksandër Stipçeviq, *Ilirët- historia-jeta-kultura*, Prishtinë, 1980.  
*Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë, 1992.  
 Eqrem Çabej, *Për gjenezën e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2001.  
 Eqrem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1970.

## LITERATURA SHITESË

Mid`hat Frashëri, *Plagët tona*, Prishtinë, 1996.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e popullit shqiptar I*, Tiranë, 2002.

F.Konica, *Kopshiti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Tiranë, 1995.

### **Vërejtje për studentin:**

*Studentët duhet t'u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së, rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor Pritet që secili student të vijë me kohë dhe të marrë pjesë në çdo ligjeratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së studimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.*